



A.nr.92/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.92/2026, të datës 28.01.2026, të parashtruar nga ankuesi I.K, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Taulant Ferizi, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Komuna e Fushë Kosovës, në çështjen juridike “*Ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, më datë 06.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.92/2026, e datës 28.01.2026, e parashtruar nga ankuesi, I.K.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 2497, i datës 24.12.20225, i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi I.K (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), më datë 23.01.2026, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 28.01.2026 dhe e regjistruar nën shenjë A.nr.92/2026, kundër Vendimit me numër protokolli 2497, të datës 24.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbim civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Komuna e Fushë Kosovës, ndërsa, kjo e fundit më datë 11.02.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritori administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 448/2026 të datës 28.01.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 2497 të datës 24.12.2025 të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës; Autorizimin zarfin e datës 23.10.2026; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 02.02.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 11.02.2026; Akt Emërimit e datës 22.07.2016; Aktgjykimin P.nr.1855/22 të datës 25.03.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinës-Departamenti i Përgjithshëm; Aktgjykimin PA1.nr.1108/24 të datës

02.12.2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm; Njoftimin e datës 23.12.2025 të Komandantit të Stacionit Policor në Fushë Kosovë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankuesit, **është e pabazuar, sepse:**

I. Gjendja e çështjes

Nga analizimi i shkresave të lëndës rezulton se:

- Ankuesi sipas Akt Emërimit me numër protokolli 898, të datës 22.07.2016, mbante pozitën *Zyrtar për Listën e Pagave* në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Fushë Kosovës.
- Sipas Aktgjyqimit P.nr.1855/22, të datës 22.04.2024, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ankuesi shpallet fajtor për veprën penale “Mashttrim” sipas nenit 323 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit penal, dhe gjykohet më dënim më burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe dënim më gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, aktgjykim ky i vërtetuar (i bërë i plotfuqishëm) më Aktgjykimin PA1.nr.1108/24, të datës 02.12.2024, të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti i Përgjithshëm.
- Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës më Vendimin me numër protokolli 2497, të datës 24.12.2025, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënien punës në shërbimin civil me efekt nga data 11.12.2025, mbi bazën e nenit 73 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër protokolli 2497, të datës 24.12.2025, të Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, më pretendimet se vendimi i kontestuar është nxjerr si rezultat i shkeljeve të parimit të proporcionalitetit, mungesës së arsytimit të plotë dhe logjik, sepse është zbatuar masa më e rëndë sepse nuk është bërë asnjë analizë mbi lidhjen shkakësore ndërmjet veprës penale dhe funksionit të tij, nga ky vendim kuptohet se palës nuk i është dhënë mundësia të paraqet deklaratë, prova apo qëndrime lidhur me rastin dhe në fund përmban formulim kontradiktor, sepse, në njërën anë vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa në anën tjetër zbatimi i tij nga një datë tjetër. Kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin e vendimit të kontestuar dhe kthimin e çështjes në rishqyrtim.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Kolegji i Këshillit në kuptim të bazushmërisë së pretendimeve ankimore ju referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenin 37 [Marrëdhënia e punës në shërbimin civil], paragrafin 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 2. Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në shërbimin civil është ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohet ndryshe vetëm në rastet kur parashihet shprehimisht në këtë ligj*

-Nenit 72 paragrafi 1, ku përcaktohet: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon në rastet si në vijim: 1.1. për shkaqet e përcaktuara në neni 73 të këtij ligji; ...*

-Nenin 73 [Përfundimi në rastet e caktuara nga ligji] paragrafin 1, ku përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon për rastet e përcaktuara në ligj, kur: 1.1. nëpunësja/i vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 1.2. nëpunësja/i humb shtetësinë, kur ajo kërkohet; 1.3. kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.4. mbushet mosha për pensionim sipas Ligjit të Punës; 1.5. konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit; 1.6. dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.*

Për me tepër, Kolegji i Këshillit për trajtim meritore të pretendimeve ankimore mori parasysh edhe nenin 5 të Rregullores (QRK) Nr.29/2024 për Përfundimin e Marrëdhënies së Punës në Shërbimin Civil, më të cilin përcaktohet se: *1. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil përfundon në rastet si në vijim: 1.1. nëpunësi vdes, apo merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij; 3 / 5 1.2. nëpunësi humb shtetësinë, kur ajo kërkohet; 1.3. kur merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar; 1.4. arrihet mosha për pensionim sipas Ligjit përkatës për Punë; 1.5. konstatohet paligjshmëria e aktit të emërimit; 1.6. nëpunësi dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.*

Referuar kuadrit të lartcekur ligjor, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e kontestuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë konstatoi se Vendimi me numër protokolli 2497, i datës 24.12.2025, i Kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës, përmes të cilit ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të dënimit me vendim gjyqësor për veprën penale me dashje, është nxjerrë më vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike si dhe në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e ligjit material. Rrjedhimisht, Kolegji vlerëson se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore për përfundimin e marrëdhënies së punës siç përcaktohet me nenin 73, paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 ndërlidhur me nenin 72, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, mbi faktet se më Aktgjykimin e plotfuqishëm P.nr.1855/22 të datës 22.04.2024 të Gjykatës Themelore në Prishtinë ankuesi është shpall fajtor për veprën penale “Mashttrim” sipas nenit 323 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal, dhe është gjykuar më dënim më burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti dhe dënim më gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, pra kemi tri elemente të plotësuar: 1. ankuesi është dënuar për vepër penale, 2. vepra penal është konstatuar nga gjykata të jetë kryer më dashje dhe vendimi gjyqësor është i plotfuqishëm.

Lidhur me pretendimin së është shqiptuar masa më e rëndë duke mos u vërtetuar ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet veprës penale dhe funksionit të tij dhe duke mos i hënë mundësia palës që të paraqet deklaratë, Kolegji thekson faktin së dënimi i nëpunësit civil për vepër penale të kryer më dashje, përbën shkak *ex lege* për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbim civil dhe së në rastin e tillë nuk kërkohet zhvillimi i ndonjë procedurë ku pala do ketë mundësinë e deklarimit. Gjegjësisht, përfundimi i marrëdhënies së punës mbi ketë shkak nuk është masë disiplinore, por siç u tha me lart, është përfundimi i marrëdhënies së punës sipas **fuqisë së ligjit**.

Andaj, nisur nga të gjeturat dhe konstatimet si më lartë, Kolegji i Këshillit erdhi në përfundimin së vendimi i goditur me ankesë është akt administrativ i ligjshëm dhe së i njëjti është nxjerr nga organi kompetent siç përcaktohet më nenin 14 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kështu që, pretendimet ankimore janë të pabazuara ligjërisht.

Theksuar për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.92 /2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Avokatit Taulant Ferizi;
- Komunës së Fushë Kosovës: Kryetarit të Komunës dhe Njesisë së Personelit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.